

VENDIM
Nr.717, datë 29.10.2004

PËR KATEGORIZIMIN E BIBLIOTEKAVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10 të nenit 28 të ligjit nr.8576, datë 3.2.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bibliotekat publike, në varësi të koleksioneve, numrit të përdoruesve dhe të shërbimeve bibliotekare që kryejnë, kategorizohen në tri nivelet e mëposhtme:

- Niveli i parë

A) Bibliotekat publike, me koleksion bibliotekar mbi 200 000 njësi dhe me numër përdoruesish mbi 4000 vetë.

B) Bibliotekat publike, me koleksion bibliotekar mbi 100 000 njësi dhe me numër përdoruesish mbi 3000 vetë.

- Niveli i dytë

A) Bibliotekat publike, me koleksion bibliotekar mbi 80 000 njësi dhe me numër përdoruesish mbi 2000 vetë.

B) Bibliotekat publike, me koleksion bibliotekar mbi 50 000 njësi dhe me numër përdoruesish mbi 1200 vetë.

- Niveli i tretë

Bibliotekat publike, me koleksion bibliotekar deri me 50 000 njësi dhe me numër përdoruesish deri me 1200 vetë.

2. Ngarkohen Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano